



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 839/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Habib Mustafa, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Habib Mustafa, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, me shenjën ZL.Anr.839/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.839/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesi i apelit Rafet Fetahu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, i cili pretendon se në bazë të Formularit të Rezultateve të Kandidatëve-FRK në QV 2117B/03D, ka poseduar, 44 vota, ndërsa pas rezultatit përfundimtar të QNR-së i ka vetëm 41 vota.

Parashtruesi i apelit si provë ka bashkangjitur kopjet Formularit të Përputhjes së Rezultateve-FRP.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve të apellesit gjeti se apeli është i pabazuar sepse provat e ofruara nuk janë bindëse. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa

argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si i tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, ndosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.839/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

The image shows a circular official stamp of the Panel for Complaints and Appeals (PZAP) in Prishtinë. The stamp contains the text 'Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës', 'PZAP', 'Prishtinë', and 'Kryesuese e Panelit'. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*